HISTORI E VËRTETË



# DORI

## VAJZA QË NUK E DONTE ASKUSH

TEKSTI: ARLENE ADAMS
VIZATIMI: GEINENE HAYNES, JOHN HARMS

# DORI

## VAJZA QË NUK E DONTE ASKUSH










TË LUTEM MAMI... MË PËRQAFO DHE MUA!
O, MOS MË SHQETËSO, UNË JAM SHUMË E LODHUR!
MAMI SHKOI NË KUZHINË...
HEJ DORI! KE THYER EDHE NJË GOTË TJETËR SOT! TI, BUDALLAQE... NUK DI TË BËSH GJË NË RREGULL?
AJO E QËLLOI SHUMË FORT ME SHUPLAKË.
KJO DO TË TË MËSOJË TË JESH MË E KUJDESSHME HERËN TJETËR!
SHKO NË KREVAT, TI NUK E MERITON TË HASH SONTE!
NET TË TËRA DORI SHTRIHEJ NË KREVAT DHE QANTE PA ZË, QË E ËMA TË MOS E DËGJONTE.
PSE NUK MË DO AJO MUA? PSE DO VETËM MERIN, DHE JO MUA? PSE MË THOTË SHPESH QË JAM E SHËMTUAR?
MERI, JA KU ËSHTË NJË GOTË ME UJË PËR TY...DHE NJË COPË BUKË ME REÇEL.
DORI VAZHDONTE TË KUJDESEJ PËR MOTRËN E SAJ TË VOGËL.


DITËT DHE MUAJT KALUAN, POR GJENDJA NUK NDRYSHOI...
DORI E DINTE QË ASNJË NUK E DONTE. NË SHTËPINË E TYRE NUK KISHTE TË QESHURA, LODRA, GJITHÇKA ISHTE E MËRZITSHME.
POR NJË DITË, GJITHÇKA NDRYSHOI. NËNA ERDHI NË SHTËPI ME NJË LAJM TË TRONDITSHËM.
VISHNI XHAKETAT DHE EJANI ME MUA. UNË NUK MUND TË KUJDESEM MË PËR JU, DO T'JU ÇOJ NË SHTËPINË E FËMIJËVE.
?
ATO UDHËTUAN ME TREN. DORI MBANTE NË DORË NJË ÇANTË LETRE, NË TË CILËN KISHTE FUTUR DISA RROBA.
Ç'DO TË THOTË AJO ME SHTËPI FËMIJE? ÇFARË LLOJ SHTËPIE?
ATO NDALUAN KUR MBËRRITËN PARA NJË DERE PREJ HEKURI...
NËNA E TYRE U THA TË HYNIN BRENDA.
?
MIRUPAFSHIM, DO TË SHIHEMI NDONJËHERË.
ATO MBËRRITËN NË KOHËN E DREKËS DHE U DËRGUAN NË NJË DHOMË TË MADHE ME TAVOLINA TË GJATA.
KUSH JANË GJITHË KËTA FËMIJË? A ËSHTË KJO NJË SHKOLLË?
MBANI QETËSI RRETH TAVOLINËS! NËSE KENI NDONJË GJË PËR TË THËNË, NGRINI DORËN!



III, E SHPIFUR! MUA NUK MË PËLQEN PANXHARI!
MËSO TA PËLQESH, TI NUK DO TË NGRIHESH NGA TAVOLINA PA E NGRËNË!
DORI ISHTE KOKËFORTË, POR DREJTORESHA ISHTE EDHE MË KOKËFORTË.
KALOI DREKA... KALOI DARKA...DORI NUK E KISHTE PREKUR ME DORË, POR AJO NUK MUND TË NGRIHEJ NGA TAVOLINA.
MË NË FUND ERDHI KOHA PËR TË FJETUR. MERI ISHTE LARGUAR PREJ SAJ DHE ISHTE DËRGUAR NË NJË DHOMË ME FËMIJË TË MOSHËS SË SAJ. DORI KISHTE MBETUR VETËM. KUJDESTARJA E RRAHU DHE E DREJTOI DREJT DHOMËS SË SAJ.
NË KËTË SHTËPI TI DO TË MËSOSH T'U BINDESH URDHRAVE.
KUJDESTARJA E DËRGOI NË NJË DHOMË TË ZYMTË ME 20 KREVATE.
JA KU ËSHTË KREVATI YT. FUTI RROBAT NË ATË KARTONIN DHE FLI GJUMË MENJËHERË!
A DO TË KTHEHET MAMI IM SË SHPEJTI?
O, AJO DO TË KTHEHET NDONJËHERË.
ATË NATË DORI QAU SA E ZURI GJUMI. DIÇKA QË DO TË BËNTE PËR 7 VJETËT E ARDHSHËM.


TË NESËRMEN...
SI QUHET KY VEND?
ËSHTË JETIMORE. KY ËSHTË NJË VEND KU SHKON, KUR NUK TË DO NJERI.
ZONJA GABRIEL, KUJDESTARJA, I TREGOI ASAJ DHOMËN E LODRAVE.
ÇDO FËMIJË KA NJË KUTI KU MBAN GJËRAT E TIJ, KUTIA JOTE DO TË JETË AJO ATJE NË FUND...
ÇFARË GJËRASH? UNË NUK ZOTËROJ NDONJË GJË.
A MUND TË MARR NJË NGA LODRAT E TUA?
JO, MOS I PREK...
UNË DO TË PRES KËTU SA TË KTHEHET MAMI, SHPRESOJ QË TË MOS JETË KOHË E GJATË.
POR DITËT...JAVËT KALUAN DHE NËNA E SAJ NUK U KTHYE. PAK NGA PAK DORI ARRITI TË KUPTONTE SE AJO DO TË QËNDRONTE NË KËTË VEND PËR NJË KOHË TË GJATË. AJO MËSOI SE TË JETOSH NË JETIMORE DUHET TË BËHESH E FORTË.
HEJ TI, MOS E PREK, AJO ËSHTË IMJA!
MA JEP! EDHE UNË DUA TË LUAJ!
AJO REFUZOI TË HANTE QULLIN E TËRSHËRËS QË U JEPEJ ÇDO MËNGJES.
UNË DO TA HEDH NË LAVAMAN MË VONË.
POR NJË DITË E KAPI KUJDESTARJA!
DORI!
EJA KËTU MENJËHERË!


KUJDESTARJA IA LAU GOJËN ME SAPUN... DHE PAS ASAJ QULLI I TËRSHËRËS ISHTE MË I SHIJSHËM.
III!
PAK NGA PAK ARRITI TË BËNTE NJË SHOQE...
DORI, TI MUND TË PËRDORËSH NGJYRAT E MIA.
FALEMINDERIT ESTER, DHE UNË KAM KURSYER PAK LETËR QË MË KA TEPRUAR NGA SHKOLLA.
PO PAPRITUR, NJË DITË ESTERI U ZHDUK.
KU ËSHTË ESTER?
O, AJO IKU SOT, AJO U ADOPTUA NGA NJË FAMILJE.
DORI U SHTRI NË KREVAT DHE QAU.
TË THASH QË TË MOS BËSH SHOQE TË NGUSHTA KËTU. KUR ATO LARGOHEN, TI PLAGOSESH NË ZEMËR.
MJAFT QAVE! PO TË VJEN KEQ PËR VETVETEN.
ZONJA GABRIEL I RRIHTE FËMIJËT GJITHMONË, PA NDONJË ARSYE TË VEÇANTË.
DORI RRIHEJ EDHE PËR GJËRA QË NUK I KISHTE BËRË.




ISHIN VETËM DY GJËRA NË JETËN E DORIT QË I SILLNIN KËNAQËSI! TË LEXUARIT DHE TË VIZATUARIT.







JASHTË DYQANIT TË GAZETAVE...
NJË DITË UNË DO TË BËHEM NJË ARTISTE ME FAMË. VIZATIMET E MIA DO TË JENË NË GAZETË!
POR MBI TË GJITHA, DËSHIRA E DORIT ISHTE T'I PËRKISTE NJË FAMILJEJE QË DO TA DONTE.
DUHET TË JETË E MREKULLUESHME TË KESH DIKË QË TË DO.
NJË HERË NË MUAJ, NË JETIMORE ISHTE NJË DITË SHUMË E VEÇANTË QË I MBUSHTE FËMIJËT ME GËZIM! ISHTË NJË DITË KU FAMILJET QË KISHIN DËSHIRË TË ADOPTONIN VININ PËR VIZITË, DHE ZGJIDHNIN NJË FËMIJË QË KISHIN DËSHIRË TA MBANIN.
DORI LAU FYTYRËN, KREHU FLOKËT DHE VESHI FUSTANIN MË TË BUKUR QË KISHTE.
JU LUTEM, LE TË MË ZGJEDH DIKUSH SOT!
POR ÇDO MUAJ KALOI, DHE DORI NUK U ZGJODH...
SHIKO ATË DJALIN E LEZETSHËM!
NE DO TË MARRIM KËTË VAJZËN E VOGËL ME KAÇURRELA TË VERDHA!
PAS DISA KOHËSH AJO E URRENTE KËTË DITË DHE FSHIHEJ SA HERË QË KISHTE VIZITOR.
DORI, FËMIJË I POSHTËR, DIL QË ATY.
ATA NUK MË ZGJEDHIN MUA, SEPSE UNË JAM E SHËNDOSHË DHE E SHËMTUAR! PSE TË SHKOJ?


NJË DITË, ERDHI PËR VIZITË NJË GRUP STUDENTËSH. ATA U MËSUAN FËMIJËVE KËNGË DHE U MËSUAN ATYRE HISTORI NGA BIBLA.
?
ZOTI JU DO SHUMË! AI DO TË JETË ATI JUAJ DHE DO TË KUJDESET PËR JU.
NUK ËSHTË E VËRTETË! MUA NUK MË DO NJERI!
AI TË DO AQ SHUMË, SA DËRGOI BIRIN E TIJ TË VETËM, JEZUSIN, QË TË MARRË MBI VETE DËNIMIN PËR GJITHË TË KËQIJAT QË TI KE BËRË...
TANI, TI MUND TË JESH E FALUR DHE MUND TË VISH TEK ZOTI.
A KA DËSHIRË NDONJË NGA JU T'I JAPË JETËN JEZUSIT?
UNË KAM DËSHIRË, POR KAM FRIKË SE SHOKËT E MI DO TË TALLEN ME MUA.
NËSE HARRONI NDONJË GJË NGA ATO QË THAMË SOT, MOS HARRONI KËTË...


ZOTI JU DO!
ZOTI MË DO MUA? A MUND TË JETË E VËRTETË?
ZOT, NËSE ËSHTË E VËRTETË, ATËHERË TI JE I VETMI QË MË DO. NËSE TI MË DO MUA, UNË JAM E JOTJA...
NJË PAQE E MADHE HYRI NË ZEMRËN E SAJ TË VOGËL. DHE AJO KUPTOI SE DIÇKA E MREKULLUESHME KISHTE NDODHUR.
ËSHTË E VËRTETË! ZOTI MË DO MUA UNË E NDIEJ!
ATË NATË, DORI QAU PËRSËRI...
ÇFARË KE, DORI?
POR, KËTË HERË AJO PO QANTE NGA GËZIMI!
DISA JAVË MË VONË, NË JETIMORE, ERDHI TË PUNONTE NJË KUJDESTARE E DASHUR.
DORI, A KE DËSHIRË TË VISH ME MUA NË KISHË?
KISHË, UNË NUK E DI SE ÇFARË ËSHTË KISHA, POR...PO DO TË VIJ?
ZOTI NA DO TË GJITHËVE, POR MËKATET TONA NA MBAJNË LARG TIJ...
DËNIMI PËR MËKATIN ËSHTË VDEKJA, POR JEZUSI E MORI DËNIMIN NË VENDIN TONË!


TANI, NE MUND T'I KËRKOJMË ZOTIT TË FALË MËKATET TONA, DHE RRUGA PËR TE ZOTI DO TË HAPET.
ATA QË E PRANOJNË ZOTIN, AI U JEP TË DREJTË TË BËHEN BIJ TË TIJ.
JA ÇFARË NDODHI KUR UNË U LUTA NË JETIMORE... UNË U BËRA BIJË E PERËNDISË!
DORI, UNË KAM NJË DHURATË PËR TY.
DHURATË? PËR MUA? ÇFARË ËSHTË?
ËSHTË NJË BIBËL, FJALA E PERËNDISË. LEXOJE ÇDO DITË DHE ZOTI DO TË TË FLASË NËPËRMJET SAJ.
OH, SHUMË FALEMINDERIT, KJO ËSHTË DHURATA E PARË DHE E VETME QË MË ËSHTË DHËNË!
SA E MREKULLUESHME, UNË KAM BIBLËN TIME! FALEMINDERIT ZOT. UNË TË PREMTOJ SE DO TA LEXOJ ÇDO DITË.
DORI TANI ËSHTË 13 VJEÇ DHE DUHET TË LARGOHET NGA JETIMORJA.
ATA KANË GJETUR NJË FAMILJE QË KA DËSHIRË TË KUJDESET PËR TË DHE MERIN.
ATO MUND TË RRININ NË JETIMORE VETËM SHTATË VJET.


POR FAMILJA QË I MORI NËN KUJDESTARI, NUK ISHTE SE ÇFARË ATO KISHIN SHPRESUAR...
UNË JAM SHOQE E NËNËS SATE... MË THIRR GJYSHE.
NË KËTË SHTËPI TI DUHET TË BËSH ATË QË TË URDHËROJ, NDRYSHE TË PRET KJO...KUPTON?
NË KOHËN E DARKËS...
PO, GJYSHE.
JU VAJZA MUND TË HANI MË VONË, NËSE KA TEPRUAR DIÇKA.
JU TË DYJA KUSHTONI SHUMË PËR T'U KUJDESUR. SHKONI DHE GJENI NËNËN TUAJ DHE I THONI SE UNË DUA QË AJO TË MË PAGUAJË MË SHUMË!
PO, KU MUND TA GJEJMË ATË?
KU TË DONI! AJO ËSHTË KAMARIERE NË NJË RESTORANT... SHKONI DHE GJEJENI!
SHKO, MERI... SHKO!
DHE MOS U KTHENI PA MË SJELLË PARA! NDRYSHE JU E DINI SE ÇFARË DO T'JU NDODHË!
DORI DHE MERI I RRAHËN RRUGËT DUKE KËRKUAR TË ËMËN, NGA NJË RESTORANT NË TJETRIN...


TË LUTEMI ZOTËRI, NE JEMI DUKE KËRKUAR NËNËN TONË.
KËTU NUK PUNON NDONJË GRUA ME FËMIJË.
PAPRITUR, JA KU ËSHTË AJO...
MAMI, MAMI, MË NË FUND TË GJETËM!
DORI, LARGOHU! UNË NUK JAM NËNA JOTE!
TË LUTEM, MAMI, GJYSHJA DO PARA.
I THONI ASAJ QË NUK KAM. TANI LARGOHUNI!
U KTHYEN TE GJYSHJA...
JU VAJZA BUDALLAÇKA, JU THASHË QË TË MOS KTHEHENI PA PARA!
ZOT I DASHUR, ÇFARË KA NDODHUR? UNË U LUTA QË TË GJEJMË MAMIN, TI NA NDIHMOVE QË TA GJENIM, POR AJO NUK NA DESHI DHE NUK NA DHA NDONJË LEK.
POR, ZOTI PO KUJDESEJ PËR DORIN. DHE PAK MË VONË...
AJO DHE MERI U MORËN NGA SHTËPIA E GJYSHES DHE U DËRGUAN NË NJË KONVIKT.



MERI, A I PE MBULESAT E BUKURA MBI KREVATET TONA?
PO! DHE KY USHQIM ËSHTË I SHIJSHËM GJITHASHTU!
KY KONVIKT ISHTE NJË NGA VENDET MË TË MIRA QË ATO KISHIN PARË, POR ATO QËNDRUAN ATY VETËM KATËR MUAJ.
MBLIDHNI RROBAT, VAJZA. NE KEMI GJETUR NJË FAMILJE QË DO TË KUJDESET PËR JU!
MERI, A E DËGJOVE ATË, DIKUSH KA DËSHIRË TË KUJDESET PËR NE!
NUK MUND TA BESOJ! PAS GJITHË KËTYRE VITEVE!
VAJZAT NUK DO TË ISHIN GËZUAR AQ SHUMË, NËSE DO TË KISHIN DITUR SE ÇFARË FAMILJE ISHTE DUKE I PRITUR.
GJYSHE! NE DO TË VIJMË PËRSËRI TE SHTËPIA JOTE?
JO! KJO GRUAJA DO T'JU ÇOJË TE NJË FAMILJE QË NJEH NËNËN TUAJ.
OH JO! NUK DUKET MIRË.
TE SHTËPIA E MAKINS.
NUK DUA TË DËGJOJ BUDALLALLËQE, TI KE ARDHUR KËTU PËR TË PUNUAR, DHE TANI SHKO NË KUZHINË DHE FILLO TË PUNOSH!
OH, JO PËRSËRI.


TI VAJZË BUDALLAQE, PSE U VONOVE KAQ SHUMË DUKE BËRË PAZARIN?
TË LUTEM, MOS MË QËLLO! UNË U MUNDOVA QË TË VIJA SA MË SHPEJT...
MERI, PSE MË RRAHIN GJITHMONË MUA DHE JO TY? ÇFARË GABIMI BËJ UNË?
NUK E DI.
MERI FJETI ME VAJZËN E SHTËPISË, POR DORI FJETI PËR TOKË NË KORIDOR, DHE SHPESH...
BURRA TË PANJOHUR KALONIN ATY KUR SHKONIN NË DHOMËN E ZONJËS MAKINS.
MOS MË PREK!
KUR ATA U LARGUAN AJO QAU MBI JASTËKUN E SAJ...
DORI ISHTE NË NJË MOSHË QË KUPTONTE SE ÇFARË DONIN ATA BURRA.
DORI DËSHIRONTE TË DUHEJ NGA NJERËZIT, POR ASNJËRI NUK E DONTE, KËSHTU AJO U KTHYE PËRSËRI TE ZOTI.
FALEMINDERIT ATË QË MË DO.
ÇDO MËNGJES AJO KYÇTE VETEN NË BANJO DHE LUTEJ. ZOTI I FOLI ASAJ NËPËRMJET BIBLËS.
OH, KY ËSHTË NJË PREMTIM I MREKULLUESHËM. DUHET TA MËSOJ PËRMENDËSH!
MOS KI FRIKË, SE UNË JAM ME TY.


ZOT I DASHUR, TË LUTEM MË NDIHMO SOT NË SHKOLLË. DHE MOS E LEJO ZONJËN MAKINS TË MË RRAHË.
SHPESH, ZOTI I FOLI DORIT NËPËRMJET FJALËVE TË BIBLËS QË AJO KISHTE MËSUAR PËRMENDËSH...
AH, SIKUR TË KISHA NJË FUSTAN TË TILLË.
"DORI, TI JE VESHUR SHUMË BUKUR ME DREJTËSINË E PERËNDISË."
NJË DITË TJETËR...
KAM SHUMË URI, AH SIKUR TË KISHA CA TË HOLLA TË BLIJA DIÇKA PËR TË NGRËNË.
"NJERIU NUK DUHET TË JETOJË VETËM ME BUKË..."
AH, SIKUR TË KISHA DIKË QË TË MË MBANTE PËR DORE.
"DORI, UNË DO TË JEM NËNA DHE BABAY YT, MOTRA DHE VËLLAI YT. UNË JAM GJITHMONË ME TY."
UNË DO TË FLE NË PAQE, SEPSE AI PO KUJDESET PËR MUA!


NJË TË DIEL PASDITE...
JAM KURESHTARE NËSE KA DIÇKA NË RADIO!
FALEMINDERIT JEZUS QË MË DO MUA...
OH, SA MUZIKË E BUKUR!
QË NGA AJO DITË AJO U LUT QË ZONJA E SHTËPISË TË LARGOHEJ ÇDO TË DIEL PASDITE, QË AJO MUND TË DËGJONTE PROGRAMIN E KRISHTERË NË RADIO.
FJALA E ZOTIT THOTË... "EJANI TEK UNË, O JU TË LODHUR, DHE UNË DO T'JU JAP QETËSI..."
TË DIELËN, DORI DOLI DHE KËRKOI NËPËR RRUGËT E QYTETIT PËR NJË KISHË.
Shërbesa e kishës, të dielën ora 10 e mëngjesit.
AJO FILLOI TË SHKONTE NË NJË KISHË BAPTISTE DHE PAS DISA KOHËSH U PAGËZUA.
UNË TË PËRKAS TY, O ZOT, DHE DUA QË E GJITHË BOTA TA DIJË!
UNË TË PAGËZOJ TY, NË EMËR TË ATIT, BIRIT DHE SHPIRTIT TË SHENJTË.
POR FAMILJES MAKINS NUK I PËLQEU KJO...
PSE HUMBET KOHËN KOT DUKE SHKUAR NË KISHË? MË MIRË PRI DRU SE SA TË SHKOSH NË NDONJË VEND!


ATA VAZHDONIN TA RRIHNIN DORIN. NJË DITË NË SHKOLLË...
DORI, ME ÇFARË E VRAVE SYRIN?
HËMMM...E GËRVISHTA NË MUR.
NUK MUND T'I TREGOJ ASKUJT SE ÇFARË NDODH NË SHTËPI. NËSE MAKINS E MARRIN VESH, ATA DO TË MË TRAJTOJNË EDHE MË KEQ.
DORI, PO TË DEL GJAK NGA HUNDA!
MMM...U RRËZOVA KUR PO VIJA NË SHKOLLË.
POR MË NË FUND, NJË DITË PAS SHKOLLËS...
A JENI JU DORI DUKUORTH?
P...PO.
NËNA JUAJ ËSHTË DËNUAR PËR KEQTRAJTIMIN E FËMIJËVE TË SAJ, DHE NE E KEMI LAJMËRUAR EDHE FAMILJEN NË TË CILËN JU PO QËNDRONI TANI.
OH, JO! KJO ËSHTË MË E KEQJA NGA TË GJITHA!
MË VONË ATË DITË TE MAKINS...
EJA KËTU, TI E POSHTËR!


SI MUND TË NA BËSH NJË GJË TË TILLË? NE TË KEMI DHËNË STREHË, NE JEMI TREGUAR TË MIRË ME TY!
DHE TI NA RAPORTON TEK POLICËT!
MOS, MOS! DO TË MË VDESËSH!
ZOT I DASHUR, KJO ËSHTË MË SHUMË SE MUND TË PËRBALLOJ, TË LUTEM MË NXIRR NGA KJO SITUATË.
DHE ZOTI E DI SE SA MUND TË MBAJMË MBI VETE...
DISA DITË MË VONË NË DHOMËN E GJYQIT...
DORI DUKUORTH, DIL PËRPARA.
LAURA DUKUORTH. A ËSHTË KJO VAJZA JUAJ?
PO, BESOJ. POR GJYKATËS, UNË DO TA KISHA ZHDUKUR NGA JETA IME PARA SE TA LINDJA, NËSE DO TË KISHA MUNDUR.
PAS PAK GJYKATËSI DHA VENDIMIN.
DORI DHE MERI DO TË MERREN PREJ JUSH PËRGJITHMONË DHE NE DO TË KUJDESEMI PËR TO.
DORI, TI DO TË LARGOHESH NGA MAKINS DHE DO TË SHKOSH NË NJË SHTËPI TË RE.
O ZOT FALEMINDERIT! ËSHTË DORA JOTE!
NËNA E SAJ ISHTE E EGËRSUAR.
NËSE MË DEL MË PËRPARA, DO TË TË VRAS!


MË NË FUND DORI E KUPTOI SE PSE NËNA E SAJ E URRENTE KAQ SHUMË...
AJO ISHE 15 VJEÇ DHE NUK ISHTE E MARTUAR KUR MË LINDI MUA.
AJO MENDON SE ËSHTË FAJI IM PËR GJITHÇKA QË KA NDODHUR NË JETËN E SAJ.
AJO U MARTUA PËR SHKAKUN TIM, POR BABAI IM E LA PAS PAK KOHËSH...
TË LUTEM, ZOT, MË NDIHMO...QË TË MUND TË FAL NËNËN TIME. ËSHTË E VËSHTIRË, POR UNË E DI QË TI DO QË UNË TA FAL ATË.
NDËRKOHË QË DORI PO MUNDOHEJ TË FALTE NËNËN E SAJ PËR GJITHÇKA TË KEQE QË AJO KISHTE SHKAKTUAR NË JETËN E SAJ, PAQJA E ZOTIT HYRI NË ZEMRËN E SAJ. HIDHËRIMI U LARGUA, ZOTI FILLOI TË SHËRONTE PLAGËT E SHPIRTIT TË SAJ.
NDËRKOHË QË MERI QËNDROI ME FAMILJEN MAKINS, NJË FAMILJE TJETËR KISHTE DËSHIRË TË KUJDESEJ PËR DORIN. AJO FUTI RROBAT NË ÇANTË DHE DOLI JASHTË PËR TË TAKUAR TË PANJOHURIT.
MIRËDITA, DORI. TI JE E MIRËPRITUR KËTU!
EDHE PSE ATA KUJDESESHIN PËR TË, KJO NUK MJAFTOI TË PËRMBUSHTE DËSHIRËN E DORIT PËR T'U DASHUR.
AH, SIKUR TË MË DONIN SADO PAK!
DORI DHE MERI TAKOHESHIN ÇDO DITË NË SHKOLLË.
DORI, UNË KAM NJË LAJM QË DUA TË TË THEM...UNË DO TË MARTOHEM!
OH MERI, TI JE E VOGËL, TI JE VETËM 15 VJEÇ!
MBARO SHKOLLËN NJËHERË, DHE PAS ASAJ DO TË PUNOJMË PËR PAK...
TI NUK MË KUPTON, UNË...
DORI, UNË DUHET TË MARTOHEM...UNË JAM SHTATZËNË!
O, PSE NUK U KUJDESA MË SHUMË PËR TË! AJO ISHTE DUKE KËRKUAR DIKË QË TA DONTE, ASHTU SI DHE UNË...
POR GJATË KËTIJ KËRKIMI, AJO RA NË GRACKË.


KU PO SHKON?
MOTRA IME MERI DO TË MARTOHET SOT.
TI NUK DO TË SHKOSH NË DASMË!
POR...AJO KA NEVOJË PËR MUA!
AJO NUK KA VLERË! PO ASHTU SI DHE NËNA JOTE! NE NUK DUAM QË TI TË BËHESH SI AJO!
O ZOT, JETA QENKA SHUMË E VËSHTIRË. TË LUTEM, MË NDIHMO TË PËRBALLOJ GJITHË KËTO VUAJTJE.
DHE TË LUTEM, NDIHMO MERIN DHE BURRIN E SAJ. TREGOJU ATYRE SE TI I DO, DHE KUJDESESH PËR TA!
NJË DITË KUR DORI ISHTE 16 VJEÇ, SHKOI PËR NJË VIZITË TE SHTËPIA E FËMIJËVE NË TË CILËN KISHTE JETUAR DISA VITE.
DOKTOR UELLÇ!
DORI! SA KËNAQËSI QË TË SHIKOJ PËRSËRI. SI JE, SI PO KALON?
MIRË, BESOJ.
DOKTOR UELLÇ, QË ISHTE DOKTORI I JETIMORES, E ÇUDITI DORIN ME NJË OFRIM.
A DO TË TË PËLQENTE TË JETOJE ME FAMILJEN TIME DHE TË PUNOJE PËR MUA?
OH, DO TË ISHTE KËNAQËSI! ME GJITHË QEJF!
TE SHTËPIA E UELLÇIT...
MIRË SE ERDHE DORI. SHPRESOJ QË DO TË TË PËLQEJË TË BANOSH ME NE.


KJO ËSHTË DHOMA JOTE DHE MBI KREVAT KE CA RROBA TË REJA PËR TË VESHUR.
KJO DHOMË ËSHTË VETËM PËR MUA? PSE, ËSHTË SHUMË E BUKUR.
DHE PAS PAK AJO E KUPTOI...
POR, KJO ËSHTË UNIFORMË! DO TË JEM VETËM SHËRBËTORE!
POR, DORI ISHTE E LUMTUR TE SHTËPIA E DOKTORIT. KJO ISHTE FAMILJA E VETME QË E DONTE DORIN.
TI KUJDESESH SHUMË MIRË PËR FËMIJËT, DORI. TANI EJA DHE ULU, DUHET TË JESH LODHUR SHUMË PAS NJË DITE KAQ TË GJATË.
MUND TË LEXOSH KË LIBËR TË DUASH, NË BIBLIOTEKË.
ÇFARË LIBRI PO LEXON?
BIBLËN TIME. UNË E LEXOJ ÇDO DITË.
MË MËSON RRETH ZOTIT, DHE UNË KAM DËSHIRË TA NJOH ATË MË MIRË. AI MË ËSHTË NDODHUR PRANË DHE MË KA NDIHMUAR NË ÇDO SITUATË.
MË BËHET QEJFI QË FEJA KA QENË NJË INKURAJIM GJATË KËTYRE VITEVE TË VËSHTIRA TË JETËS SATE.
POR, ZONJA UELLÇ, ËSHTË MË SHUMË SE INKURAJIM. JEZUSI MË KA FALUR MËKATET DHE UNË JAM PJESËTARE E FAMILJES SË ZOTIT.
AI DO TË BËJË TË NJËTËN GJË PËR TY, NËSE TI IA KËRKON.
UNË NUK KAM NEVOJË PËR ZOTIN, DORI. UNË KAM NJË BURRË SHUMË TË MIRË DHE DY FËMIJË TË MREKULLUESHËM, ÇFARË MUND TË KËRKOJ MË SHUMË.
AJO ËSHTË TREGUAR SHUMË E MIRË ME MUA, AH SIKUR TË MUND TA NDIHMOJ QË AJO TA KUPTOJ TË VËRTETËN.


DORI MBAROI SHKOLLËN E MESME DHE SHKOI NË KOLEGJ PËR TË STUDIUAR ART. AJO ËSHTË 19 VJEÇ DHE TANI AJO E DI SE NUK MUND TË PUNOJË PËRGJITHMONË SI SHËRBËTORE NË KËTË FAMILJE. NJË DITË DOKTOR UELLÇ E ÇUDITI...
DORI, KU ËSHTË BABAI YT?
BABAI IM? NUK E DI. NUK E KAM TAKUAR NDONJËHERË.
PSE NUK MUNDOHEMI TË GJEJMË NDONJË TË DHËNË RRETH TIJ?
UNË DËGJOVA NJËHERË SE AI BANON DIKU NË OKLOHOMA.
CENTRALISTE? UNË JAM MJEK. A MUND TË MË TREGOSH NËSE ZOTI DUKUORTH BANON NË TOLSA, OKLOHOMA?
NJË MINUTË, TË LUTEM...PO AI BANON ATJE, A E DONI NUMRIN E TELEFONIT TË TIJ?
JO, FALEMINDERIT. UNË VETËM DOJA TË DIJA NËSE BANON ATJE, MIRUPAFSHIM.
DORI, UNË MENDOJ TË GJEJMË ADRESËN E BABAIT TËND DHE T'I DËRGOJMË NJË LETËR.
SA E ÇUDITSHME T'I SHKRUAJ NJË BURRI QË NUK E KAM TAKUAR MË PARË, DHE TA PYES NËSE AI ËSHTË BABAI IM.
DY JAVË MË VONË...
A MUND TË HEDHËSH FIRMËN KËTU PËR KËTË LETËR, TË LUTEM?
ËSHTË PËR MUA!


HAPE SHPEJT!
NUK MUNDEM, ËSHTË NGA ZOTI DUKUORTH!
NUK MUND TA LEXOJ, VETËM
MË THUAJ SE ÇFARË THOTË.
MA JEP, UNË MUND TA HAP PËR TY.
UNË E KAM GJETUR BABAIN TIM!
SHIKO SE SI E KA FIRMOSUR!
Me dashuri nga babai.
UNË NUK MUND TA BESOJ SE JE TI QË MË KE SHKRUAR. MË BËHET QEJFI QË JE MIRË, TË LUTEM, MË SHKRUAJ PRAPË.
NUK MUND TA BESOJ SE E GJITHË KJO ËSHTË E VËRTETË!
DISA JAVË MË VONË, RA ZILJA E TELEFONIT...
A MUND TË FLAS ME DORIN, TË LUTEM?
UNË JAM DORI.
DORI, E DASHUR, UNË JAM BABAI YT. UNË DUA TË TË TAKOJ, A MUND TË VISH PËR VIZITË?
UNË KAM FRIKË, NUK DUA TË MOHOHEM PËRSËRI.
JO, BABI. NËSE DO TË MË NJIHJE, TI NUK DO TË MË DOJE.
MOS U BË QESHARAKE! SI MOS TË TË DUA? UNË DO TË DËRGOJ GJYSMAT E PARAVE TË UDHËTIMIT. TË LUTEM, EJA SA MË PARË!


MË NË FUND, DORI MORI GUXIM TË BLINTE NJË BILETË AUTOBUZI NGA KALIFORNIA NË OKLOHOMA.
SI DO TË MUND TA NJOH?
PO SIKUR TË MOS MË DOJË?
KUR ARRITI TE STACIONI I AUTOBUZIT, DORI KËRKOI NËPËR TURMËN E NJERËZVE TË PANJOHUR.
TË LUTEM, ZOTËRI, A JENI JU BABAI IM?
DORI!
BABAI I SAJ E ÇOI ATË TE SHTËPIA E TIJ.
DORI, TAKO GRUAN TIME, BLËNÇ.
MIRËSEERDHE DORI.
DORI, PSE NUK RRI ME NE, TI MUND TË GJESH NJË PUNË KËTU.
AI KA DËSHIRË QË UNË TË RRI ME TË, AI MË DO MUA!
FALEMIN-DERIT BABI, ME KËNAQËSI.
BABA, PSE NUK U MUNDOVE TË NA GJESH?
OH, HARROJE, TË LUTEM, UNË NUK KAM DËSHIRË TË FLAS PËR TË KALUARËN.
BABI, PARA SE TË VIJA PËR TË VIZITUAR TY, UNË KISHA VETËM NJË SHOK TË VEÇANTË.
OH, KUSH ISHTE AI?



JEZUSI. KUR UNË JETOJA NË JETIMORE DHE JETA ISHTE SHUMË E VËSHTIRË, UNË IA DHASHË JETËN ATIJ DHE AI U BË SHOKU IM MË I NGUSHTË!
UNË NUK KAM KOHË PËR ZOTIN! UNË NUK DUA TË DËGJOJ TË FLASËSH MË PËR GJËRA TË TILLA.
POR BABI, AI TË DO TY!
PLEHRA! NDOSHTA TI KE NEVOJË PËR FE, POR UNË NUK KAM NEVOJË. UNË NUK DUA TË TË DËGJOJ MË TË FLASËSH PËR TË!
TI JE E RE, SHKO JASHTË DHE SHIJOJE JETËN. TI JE E RE TA MARRËSH JETËN ME KAQ SERIOZITET.
PSE KA KAQ SHUMË NJERËZ QË NUK KUPTOJNË?
DORI BANOI ME BABAIN E SAJ PËR DY VJET, POR DHIMBJA NË ZEMRËN E SAJ ERDHI DUKE U SHTUAR.
UNË NUK MUND TË KËNAQ NË TË NJËJTËN KOHË ATIN TOKËSOR, DHE ATIN QIELLOR.
ASAJ IU DUK SIKUR I FOLI NJË ZË...
KUSH TË DESHI, KUR ASNJË TJETËR NUK TË DONTE?
ËSHTË E VËRTETË! BABAI NUK ERDHI TË MË VIZITOJË KUR ISHA NË JETIMORE. AI NUK U MUNDUA TË MË GJENTE.
DHE KUR NËNA IME MË QËLLONTE DHE MË FYENTE, ZOTI ISHTE AI QË MË NGUSHËLLONTE...
ZOT, TI ISHE I VETMI QË QËNDROVE PRANË MEJE GJATË ATYRE VITEVE TË VËSHTIRA. UNË NUK DO TË KTHEJ KURRIZIN NDAJ TEJE TANI!
BABI, MUA MË ËSHTË MBUSHUR MENDJA TË KTHEHEM PËRSËRI NË KALIFORNI.
NËSE KJO ËSHTË DËSHIRA JOTE, JE E LIRË.
ME ZEMËR TË THYER DORI BËRI VALIXHEN GATI, I THA MIRUPAFSHIM TË ATIT DHE U NIS PËR NË STACIONIN E AUTOBUZIT.


TANI DORI ISHTE 21 VJEÇ. KUR U KTHYE NË KALIFORNI, GJETI NJË PUNË TË RE DHE U STABILIZUA ATJE. EDHE PSE GJITHÇKA PO SHKONTE MIRË, AJO NDIHEJ E TRAZUAR NGA BRENDA...
DORI, A MUND TË JAPËSH JETËN TËNDE DHE MUND T'U TREGOSH TË TJERËVE RRETH MEJE?
DOMETHËNË TË LË PUNËN? TË SHKOJ NË NJË VEND TË HUAJ? O ZOT, KJO DO TË JETË SHUMË E VËSHTIRË.
POR, JEZUSI E DHA JETËN E TIJ PËR MUA. SI MUND TË JAP MË PAK?
MIRË, ZOT. UNË DO TË BËJ ÇFARË TË MË THUASH DHE DO TË SHKOJ KUDO QË TË MË DËRGOSH.
JEZUSI I KËRKOI DORIT TË SHKONTE NË NJË VEND TË HUAJ, KU NJERËZIT NUK KISHIN DËGJUAR RRETH TIJ, DHE DASHURISË SË TIJ PËR TA.
UNË DUHET TË GJEJ PRINDËRIT DHE T'U THEM MIRUPAFSHIM PARA SE TË SHKOJ.
JA KU ËSHTË AJO!
AJO DUKET E KËNAQUR ME PUNËN E SAJ. A MENDON AJO NDONJËHERË PËR MUA?
A KE DËSHIRË TË FLASËSH ME TË?
JO, MË MIRË TË MOS FLAS.
AKOMA MË DHEMB ZEMRA, O ZOT, POR FALEMINDERIT QË MË NDIHMOVE QË TË MUND TA FALJA ATË. TË LUTEM, BEKOJE ATË. AJO KA NEVOJË TË TË NJOHË TY.
UNË NUK MUND TA NDRYSHOJ TË KALUARËN, MË NDIHMO TA HEDH PAS SHPINE. TI KE NJË TË ARDHME PËR MUA DHE UNË DUA TË EC PËRPARA.
DHE MË VONË AJO U NIS PËR NË OKLOHOMA, QË T'I TREGONTE BABAIT PËR VENDIMIN E SAJ DHE TË NDAHEJ ME TË.
BABI!
TUNGJATJETA, BIJA IME, JAM I KËNAQUR QË TË SHOH.


BABAI I DORIT KISHTE NJË ZEMËR TË DOBËT DHE AI NDIHEJ SHUMË I SËMURË.
DORI, UNË GJITHMONË KAM DITUR SE SI TA JETOJ JETËN, POR NUK DI SE SI TË VDES, DHE E VËRTETA ËSHTË SE JAM DUKE VDEKUR.
KRISHTI ËSHTË I VETMI QË MUND TË NA PËRGATITË PËR VDEKJEN. TI MUND TË PRANOSH ATË.
JO! UNË NUK E DESHA ATË KUR ISHA I SHËNDOSHË, DHE NUK E DUA AS TANI!
POR, BABA, AI TË DO TY!
MOS FOL MË! UNË NUK DUA TË DËGJOJ MË PËR TË!
BABI, UNË ERDHA TË TË THEM SE UNË DO TË BËHEM MISIONARE, DHE DO TË SHKOJ NË NJË VEND TË HUAJ, QË TË MUND T'U TREGOJ NJERËZVE PËR JEZUSIN.
NËSE KE VENDOSUR TË BËSH JETËN TËNDE NË NJË MËNYRË TË TILLË, MOS RRI KËTU, SHKO PRAPË NË KALIFORNI!
BABI! SERIOZISHT E KE?
PO!
UNË NUK DUA TË TË SHOH PËRSËRI.
DORI MORI VALIXHEN DHE U LARGUA ME TAKSI!
LAMTUMIRË, BABA...UNË TË DUA SHUMË!
KJO ISHTE HERA E FUNDIT QË AJO E PA BABAIN E SAJ.
ZOT, AI ISHTE I VETMI PERSON QË MË KA DASHUR, SI MUND TË MA BËNTE NJË GJË TË TILLË?
ZOTI I FOLI ZEMRËS SË SAJ TË THYER NDËRSA AJO U LARGUA...
"ASGJË NUK DO TË MUND TË TË NDAJË TY NGA DASHURIA IME."
"UNË KURRË NUK DO TË TË LË, OSE TË BRAKTIS TY."


NËNA IME MALLKON DITËN QË MË LINDI...BABAI IM NUK E ÇAU KOKËN PËR MUA KUR UNË ISHA E VOGËL DHE TANI MË MOHON..
VETËM NJË SHOK KURRË NUK MË BRAKTISI. JEZUSI! FALEMINDERIT ZOT, TI NUK DO TË MË BRAKTISËSH TANI, POR TË LUTEM, MBYLLI PLAGËT E ZEMRËS SIME!
TEK SHKOLLA E PËRGATITJES SI MISIONARE...
SA DJALË SIMPATIK. DO TË JETË ME FAT VAJZA QË AI DO TË ZGJEDHË!
AJO QENKA VAJZË E LEZETSHME, SI DO TA KETË EMRIN VALLË?
DORI, A KE DËSHIRË TË HASH DREKË ME MUA?
ME GJITHË QEJF!
LLOID DHE DORI U TAKUAN ME NJËRI-TJETRIN RREGULLISHT PAS KËSAJ DITE, DHE MARRËDHËNIA MES TYRE U THELLUA NGA DITA NË DITË.
DORI, UNË TË DUA, A DO TË MARTOHESH ME MUA?
PATJETËR, ME GJITHË ZEMËR!
MË VONË...
ZOT, SI MUND TË TREGOHESH KAQ I MIRË ME MUA, DUKE LEJUAR NJË DJALË TË RI TË MË DOJË? PËR TË PARAQITJA IME NUK KA RËNDËSI. MË DUKET SI NJË ËNDËRR.
DHE ZOTI IU PËRGJIGJ NËPËRMJET FJALËS SË TIJ...
AI QË LË SHTËPINË, VËLLEZËRIT DHE MOTRAT, NËNËN DHE BABAIN, PËR SHKAKUN TIM, DO TË SHPËRBLEHET NJËQIND HERË MË SHUMË DHE DO TË TRASHËGOJË JETËN E PËRJETSHME.


ZOT, BËJ QË JETËT TONA TË JENË BEKIM NË KËTË BOTË, DHE SHTËPIA JONË TË BEKOJË TË TJERËT.
O ZOT, NËSE MUND TË MË BËSH TË BUKUR VETËM PËR NJË DITË, TË LUTEM LE TË JETË SOT!
FALEMINDERIT ZOT, SOT UNË NDIHEM E BUKUR!
PASI LLOID DHE DORI U MARTUAN ATA SHKUAN SI MISIONARË NË GUINEN E RE, NJË ISHULL SHUMË I MADH NË JUG-PERËNDIM TË AZISË.
GUINEJA E RE.
ATA U TREGUAN SHUMË NJERËZVE PËR ZOTIN.
ZOT, TË LUTEM TË MË FALËSH TË GJITHA MËKATET E MIA. HYR TANI NË JETËN TIME.
DHE SHUMË BESUAN KËTË LAJM TË MIRË DHE IA DHANË ZEMRËN PERËNDISË.
KUR AJO ARRITI TË ZBULONTE DASHURINË E ZOTIT, E SHNDËRROI ATË NË NJË GRUA ME PASION DHE DASHURI PËR TË TJERËT.
VAJZA E VOGËL DHE E VETMUAR, E CILA U UL DHE PRITI SHUMË KOHË DUKE SHPRESUAR QË DIKUSH DO TË MUND TA DONTE...


DISA VITE MË VONË DORI MUND T'U TREGONTE FËMIJËVE TË SAJ...
NËPËRMJET VUAJTJEVE TË MIA, UNË ARRITA TË NJOH ZOTIN DHE MËSOVA SE AI MUND TË MARRË DIKË QË NUK KA VLERË DHE TA KTHEJË NË DIKË "ME VLERË." NËSE HARRONI GJITHÇKA QË JU THEM, MOS HARRONI KËTË...
ZOTI TË DO TY!
EDHE PAS KAQ SHUMË VITESH, DORI VAZHDON T'UA TREGOJË KËTË HISTORI SHUMË FËMIJËVE NË MBARË BOTËN.
A KE DËSHIRË TA PRANOSH ZOTIN SI ATIN TËND, ASHTU SIÇ E KAM PRANUAR UNË? DO TË MUNDOHEM TA SHPJEGOJ.
QË KUR UNË ISHA SHUMË E VOGËL UNË E DIJA QË NE BËJMË SHUMË GJËRA TË KËQIJA SI...
DO TA PËSHTYJ MË VONË NË LAVAMAN.
GËNJEJMË...
DORI, EJA KËTU MENJËHERË!
UNË URREJA SHUMË NJERËZ DHE SHUMË SHPESH KISHA XHELOZI NDAJ TË TJERËVE.
VJEDHIM...
NUK BINDEMI.
ZOTI I QUAN TË GJITHA KËTO, "MËKAT"



BIRI I ZOTIT MORI MËKATET TONA MBI VETE DUKE VDEKUR NË KRYQ.
ZOTI
JEZUSI
NJERIU
ZOTI ËSHTË NJË ZOT I SHENJTË, DHE MËKATET TONA NA NDAJNË NGA AI. ZOTI THOTË SE MËKATI DUHET TË DËNOHET ME VDEKJE.
NËSE BESON SE JEZUSI VDIQ PËR TY NË KRYQ DHE MUND T'I LUTESH QË AI TË FALË MËKATET E TUA, ATËHERË TI DO TË BËHESH FËMIJË I TIJ. AI DO TË VIJË DHE DO TË JETOJË NË ZEMRËN TËNDE NËPËRMJET SHPIRTIT TË TIJ, DHE DO TË NDIHMOJË QË TI TË MUND TË BËSH NJË JETË TË RE NË TË.
MËKATI
LAJM I MREKULLU-ESHËM!
JEZUSI ËSHTË I GJALLË SOT!
AI U RINGJALL NGA TË VDEKURIT DHE U KTHYE NË PARAJSË.
A KE DËSHIRË TË VISH TE ZOTI DHE T'IA JAPËSH JETËN ATIJ? ATËHERË LUTU PAS MEJE...
ZOT I DASHUR, FALEMINDERIT QË DËRGOVE JEZUSIN PËR TË MARRË MËKATET E MIA NË KRYQ.
TË LUTEM, MË FAL TË GJITHA MËKATET QË KAM BËRË. HYR NË JETËN TIME DHE MË SHPËTO, DHE TË LUTEM, DREJTOJI HAPAT E MIA QË NGA KY MOMENT.
MIRËSEERDHE NË FAMILJEN E ZOTIT! DHE AI TË PREMTON SE NUK DO TË HARROJË OSE BRAKTISË TY KURRË. KËTO JANË TRE HAPA TË RËNDËSISHME QË MUND TË NDIHMOJNË TA NJOHËSH ZOTIN MË MIRË.
1.
FOL ÇDO DITË ME ZOTIN NËPËRMJET LUTJEVE.
2.
LEXO BIBLËN, NËSE KE NJË. AI DO TË TË FLASË NËPËRMJET SAJ DHE DO TË DREJTOJË HAPAT E TUA ÇDO DITË.
3.
TAKOHU ME BESIMTARË TË TJERË SA MË SHPESH QË TË JETË E MUNDUR.
ATA JANË FAMILJA JOTE E RE DHE DO TË TË INKURAJOJNË DHE NDIHMOJNË QË TË RRITESH NË BESIM.

THIS COMIC IS AN ADAPTION OF THE BOOK:
**DORIE: THE GIRL NOBODY LOVED**
© 1979 PUBLISHED ORIGINALLY BY MOODY PRESS.

INTERNATIONAL COPYRIGHT SECURED
FOR THE COMIC EDITION THROUGH MOODY PRESS.
© 2002 FOR THE ALBANIAN **DORIE COMIC**
BY OPERATION MOBILISATION GREATER EUROPE.
ALL RIGHTS RESERVED.

# DORI

E PËRBUZUR – E PADËSHIRUAR – E KEQTRAJTUAR

DORI I KA PËRJETUAR T Ë GJITHA KËTO SI NJË JETIME
E PËRBUZUR NGA PRINDËRIT E SAJ, E KEQTRAJTUAR NGA NJ
Ë JETIMORE NË TJETRËN, AJO KA NJOHUR VETËM MJERIM
DHE MIZORI GJATË GJITHË FËMIJËRISË SË SAJ. POR PËRMES
TYRE, AJO ZBULOI NJË MIK SHUMË TË VEÇANTË. AI ISHTE NJË
MIK QË DO T'I QËNDRONTE AFËR ASAJ NË KOHËT MË TË VË
SHTIRA DHE TA MBUSHTE ATË ME SHPRESË NË
VEND TË DËSHPËRIMIT.

SOT DORI DO TË NDAJË ME FËMIJËT NË MBARË
BOTËN KËTË MESAZH SHPRESE:
UNË KAM MËSUAR SE AI MUND T'I MARRË
"ASKUSHËT" DHE T'I KTHEJË ATA
NË "DIKUSH". NËSE DO TË HARRONI ÇDO
GJË TJETËR QË DO T'JU TREGOJ,
MOS E HARRONI KURRË KËTË...

**PERËNDIA JU DO!**





AL